



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 717 Prot.

Tiranë, më datë 13.07.2020

**VENDIM**

**Nr. 201, datë 02.07.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 02.07.2020,

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për konceptin e gërmimit arkeologjik në Kalanë e Tepelenës, me aplikues Luan Përzhita në kuadër të zbatimit të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të kalasë së Ali Pashë Tepelenës dhe vazhdimi i shëtitorës përgjatë hyrjes së kalasë loti II (segmenti porta perëndimore – busti i Selam Musait);
  - Të silllet për shqyrtim pranë KKTKM-së nga subjekti i licencuar në arkeologji koncepti i gërmim shpëtimit arkeologjik në përputhje me gjetjet e dala gjatë gjithë periudhës së monitorimit;
  - Në varësi të gjetjeve të dala gjata procesit të gërmimit, projekti duhet të vijë i rishikuar nga investitori për shqyrtim pranë KKTKM-së.
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
Arta **DOLLANI**

**KRYETAR**

Elva **MARGARITI**

